

# ME TRANSPARENCË DHE LLOGARIDHËNIE MË TË MADHE – DREJT QYTETARISË PROAKTIVE

**- FUQIZIMI I INTEGRITETIT TË KOMUNAVE-**

Kjo analizë është përgatitur në kuadër të projektit:  
“Me transparencë dhe llogaridhënie më të madhe të komunave – drejt qytetarisë proaktive”  
e implementuar nga Shoqata e Trajnuesve të Administratës Publike (PAT) Shkup

Mbështetur me një grant të vogël të veprimit i



Përmbajtja e këtij publikimi është vetëm përgjegjësi e Shoqatës së Trajnuesve të Amdinistratës Publike (PAT) Shkup dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e Civika Mobilitas, Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), ose organizatave të cilat e realizojnë.

## **PËRMBAJTJA**

- 1. Hyrje**
- 2. Metodologjia**
  - 2.1. Instrumentet e hulumtimit**
    - 2.1.1. Përpunimi dhe paraqitja e rezultateve**
- 3. Analiza**
  - 3.1. Korniza normative**
  - 3.2. Analiza e gjendjeve në Republikën e Maqedonisë**
- 4. Rekomandimet**

## **BIBLIOGRAFIA**

## 1. HYRJE

Projekti “Me transparencë dhe llogaridhënie të komunave – drejt qytatarisë proaktive” ka për qëllim të kontribuojë në identifikimin e shkallës së transparencës dhe llogaridhënies së komunave, si kusht për uljen e rreziqeve nga korrupsioni. Përmes projektit pritet komunat të marrin informacione për mekanizmat për sigurimin e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në marrjen e vendimeve, si edhe për realizimin e tyre.

Ideja e këtij projekti është të hartohen analiza dhe rekomandime të cilat do të kontribuojnë për fuqizimin e vetëdijes për nevojën e transparencës dhe llogaridhënies së komunave dhe pjesëmarrjen qytetare në nivel lokal, në drejtim të promovimit dhe krijimit të kushteve për zbatimin e parimeve për qeverisje të mirë dhe mbështetjen e procesit të decentralizimit. Transparenca e komunave, qasja në informacione për punën e organeve të komunës dhe për shërbimet publike me kompetencë lokale, si edhe llogaridhënia për vendimet e miratuara dhe të realizuara, janë faktorët mobilizues kyç për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në përgatitjen dhe realizimin e politikave lokale.

Projekti u realizua në periudhë të korrikut të vitit 2017 deri në muajin dhjetor të vitit 2017, nga ana e Shoqatës së Trajnuesve të Administratës Publike (PAT), i mbështetur nga Civika Mobilitas.

Për nevojat e projektit, u vendos komunikim midis PAT-it, komunave dhe organizatave qytetare i cili kishte për qëllim sigurimin dhe realizimin e analizës në kuadër të projektit.

## 2. METODOLOGJIA

Me këtë projekt janë përfshirë 41 komuna nga të gjitha rajonet e planifikuara të Republikës së Maqedonisë dhe 33 organizata qytetare (OQ) të cilat veprojnë në nivel lokal në Republikën e Maqedonisë. Në kuadër të projektit më së pari u zbuluan gendjet përmes hulumtimit të praktikave aktuale në komunat, mbi bazën e të dhënave të marra nga përfaqësuesit komunalë dhe OQ, pastaj u hartuan rekomandimet për ndërmarrjen e masave konkrete për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe publicitetit të komunave. Njëkohësisht u realizua edhe analiza e UEB faqeve të komunave të cilat ishin përfshirë në këtë hulumtim, kurse analiza si edhe pjesa e madhe e rekomandimeve bazohen mbi analizën e kornizës normative në Republikën e Maqedonisë, si edhe rekomandimeve dhe kahjeve të dhëna në korniza ndërkombëtare, si bazë për transparencën dhe publicitetin e institucioneve demokratike, të kahëzuara drejt qytetarit.

Raporti i përfshin gjetjet të marra mbi bazën e hulumtimit të bërë në periudhën drejtpërdrejt para zgjedhjeve lokale, në shtator dhe tetor të vitit 2107.

Hulumtimi në kuadër të këtij raporti është realizuar mbi bazën e metodologjisë paraprakisht të hartuar dhe pyetësorëve të strukturuar:

1. Pyetësi anketues për anketimin e përfaqësuesve të komunave;
2. Pyetësi anketues për anketimin e përfaqësuesve të organizateve qytetare;
3. Identifikimi i 40 komunave të synuara (mostra përfaqësuese sipas madhësisë së komunës / numri i popullatës, rajoni gjeografik, komuna qytetare/rurale) dhe organizatave qytetare;
4. Anketimi i përfaqësuesve të komunës dhe organizateve qytetare;
5. Analiza e UEB faqeve të komunave, si një nga mekanizmat themelore për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies së komunave;
6. Analiza e të dhënave dhe gjendjeve të marra dhe hartimi i rekomandimeve.

Analiza e gjendjeve dhe rekomandimeve u referohen si gjendjeve rrjedhëse, ashtu edhe shkaqeve të cilat ndikojnë mbi shkallën e transparencës dhe llogaridhënies së komunave dhe mbi bashkëpunimin e tërësishëm me organizatat qytetare <sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Për nevojat e analizës dhe të të dhënave, analizës së kornizës ligjore në Republikën e Maqedonisë, si edhe për hartimin e propozim-drejtimeve dhe rekomandimeve, në projekt ishin përfshirë bashkëpunëtorë profesionistë, të cilët e hartuan analizën dhe i dhanë rekomandimet për veprim të mëtutejshëm në drejtim të përmirësimit të transparencies, publicitetit dhe llogaridhënies së komunave.

## 2.1. Instrumentet e hulumtimit

### 2.1.1. Purpunimi dhe shfaqja e rezultateve

Në këtë hulumtim ishin përfshirë përfaqësues të pushteteve komunale dhe organizatave qytetare si përfaqësues të sektorit qytetar, të cilët dhanë vlerësimin e tyre për gjendjet nga aspekti i transparencës dhe llogaridhënies së komunave.

Me këtë hulumtim u bë përpjekje për t'u analizuar gjendjet përmes analizës gjithëpërfshirëse, e cila i mori parasysh:

#### 1. Perceptimet e sektorit qytetar përmes shkallës së:

- informimit të tyre për punën në komunë;
- përfshirjes së tyre në marrjen e vendimeve;
- mundësisë për t'i treguar dobësitë në funksionimin e komunës dhe të të punësuarve në administratën komunale dhe
- llogaridhënies së komunës

#### 2. Vlerësimet e gjendjeve nga ana e përfaqësuesve të komunës të cilët dhanë pikëpamjen e tyre për efikasitetin në sigurimin e informacioneve me rëndësi për qytetarët.

Midis të tjerash, rezultatet e hulumtimit shërbyen për t'u përcaktuar

- A janë qytetarët të informuar në kohë dhe në mënyrë adekuate nga ana e komunës?
- A janë, në cilën mënyrë dhe sa shpesh qytetarët të përfshirë në marrjen e vendimeve?
- Në cilën mënyrë, për cilat çështje dhe sa shpesh komunat bashkëpunojnë me organizatat qytetare?

Rezultatet e shfaqura bazohen në përpunimin e informacioneve të marra përmes analizës së të dhënave në internet, nga informacionet e marra nga komunat dhe nga organizatat qytetare, nëpërmjet anketimit.

Gjithashtu, është bërë edhe analiza e kornizës ligjore relevante në Republikën e Maqedonisë. Gjatë analizës i kushtohet vëmendje edhe transparencës së ashtuquajtur aktive, respektivisht, publikimit të informacioneve me vetëiniciativë të komunave.

Në fillim u bë përpjekje për t'u siguruar të dhëna nga 40 komuna të synuara të identifikuar që duhej të përfaqësonin një mostër përfaqësuese sipas madhësisë, numrit të popullatës, mbulimit të barabartë të të gjitha rajoneve dhe përfaqësimit adekuat të komunave rurale dhe urbane. Megjithatë, pas mospjesëmarrjes për t'u siguruar të dhëna nga komunat e zgjedhura, dhe me qëllim të sigurimit të të dhënave prej së paku 50% të komunave, respektivisht, së paku 40 prej tyre, u zbatua qasja joselektive e komunave.

Pas anketimit të realizuar u siguruan të dhëna prej 41 komunave: 16 komuna rurale, respektivisht 39% dhe 25 komuna urbane, respektivisht 61%. Nga sektori qytetar ishin përpunuar të dhëna të cilat ishin marrë nga 33 organizata qytetare, prej të cilave numri më i madh (75%) veprojnë në më shumë se një komunë në Republikën e Maqedonisë.

### 3. ANALIZA

#### 3.1. Korniza normative

Sistemi i vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë është i vendosur mbi parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale<sup>2</sup> dhe praktikatat e mira të vendeve, anëtare të Unionit.

Marrëveshja e parë e detyrueshme ndërkombëtare e cila i garanton të drejtat e bashkësive dhe pushteteve të tyre të përzgjedhura dhe e vendos parimin e subsidiaritetit është Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale e cila ishte hartuar në kuadër të Këshillit të Evropës, dhe e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në vitin 1997. Me nënshkrimin e saj, shtetet u obliguan ta respektojnë esencën e parimeve themelore, të drejtën e qytetarëve të marrin pjesë në udhëheqjen me punët publike.

Në korrik të vitit 2015, Republika e Maqedonisë e ratifikoi edhe Protokollin Shtesë drejt Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale për të drejtën e pjesëmarrjes në punët e pushtetit lokal i cili ka për qëllim ta përfshijë në kornizat e Kartës për vetëqeverisje lokale të drejtën e çdo individi të marrë pjesë në punën e pushtetit lokal.

Në sigurimin e kushteve për zbatimin e dispozitave ligjore, dhe përparimin e mundësive për qasje më të lehtë në informacione dhe në nxitjen e pjesëmarrjes qytetare, përmes shfrytëzimit të teknologjive të reja, udhëzon edhe Strategjia e Këshillit të Evropës për qeverisje inovative dhe të mirë në nivel lokal.

Një nga qëllimet e zbatimit të parimeve për qeverisje të mirë është fuqizimi i integritetit të komunës dhe ulja e rreziqeve nga korrupsioni i pushteteve lokale dhe i administratës lokale, që çon deri në sigurimin e shërbimeve cilësore, efikase dhe efektive publike, si edhe rritjen e besimit në pushtetet lokale.

Praktikat korruptive në sferën publike e zhvlerësojnë besimin të domosdoshëm për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e bashkësive lokale stabile, të cilat do të funksionojnë mbi bazën e parimeve të qeverisjes së mirë. Sjellja korruptive është në kundërshtim me sundimin e së drejtës, demokracisë dhe të drejtave të njeriut, meqë e pengon qeverisjen e mirë, fer qasjen dhe drejtësinë sociale, e shkatërron konkurrencën, zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin e institucioneve demokratike dhe i minon themelet etike të shoqërisë.

Qeverisja e mirë nënkupton dhe ndërtimin dhe kultivimin e frymës së integritetit në nivel personal dhe institucional, me që do të nxitet dhe do të sigurohet pavarësia, profesionaliteti dhe llogaridhënia në kryerjen e kompetencave të përcaktuara me të drejtën vendase dhe ndërkombëtare. Realizimi i Politikës së integritetit nga ana e komunave në Republikën e Maqedonisë do t'i afirmonte parimet e sundimit të së drejtës dhe do ta deklaronte qartë tolerancën zero ndaj korrupsionit.

Një nga mënyrat për luftë kundër korrupsionit dhe për fuqizimin e integritetit është transparenca dhe llogaridhënia dhe pjesëmarrja më e fuqishme e qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve, veçanërisht në nivel lokal.

E drejta e qasjes në informacione me karakter publik është e rregulluar me Ligjin për qasje të lirë

<sup>2</sup> <http://mls.gov.mk/images/laws/Karta%20Evropiane%20për%20Vetëqeverisje%20Lokale.pdf>

në informacione me karakter publik.

Në këtë kontekst është më e rëndësishme të theksohet nevoja për krijimin e kushteve nga ana e komunës për qasje proaktive në sigurimin e informacioneve me karakter publik, para se gjithash të informacioneve që dalin nga fushëveprimi i punës, në pajtim me interesin e qytetarëve. Ajo nënkupton publikim të tërësishëm dhe të rregullt të informacioneve të cilat sigurojnë llogaridhënie në punën e pushteteve lokale, por edhe të të gjitha informacioneve të tjera të cilat janë të dobishme dhe me interes për qytetarët, siç janë informacionet për shërbimet të cilat i siguron komuna dhe qasja deri te ato.

Transparenca para se gjithash paraqet mënyrë të qasjes në informacione, që më lehtë do të sigurohej, midis të tjerash, edhe përmes publikimit të tyre në UEB faqen e komunës, në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe lehtë të arritshme. Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik i përcakton informacionet deri te cilat qytetarët duhet të kenë qasje në UEB faqen e institucionit, konkretisht të komunës: aktet ligjore dhe nënligjore të institucionit; të publikojnë njoftime deri te publiku për punët të ndërmarra nga ana e tyre në pajtim me kompetencat ligjore; të publikojnë të dhëna statistikore për punën e tyre; t'i publikojnë raportet për punët të cilat i parashtrojnë deri te organet kompetente për realizimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes dhe në mënyrë tjetër të paraparë me ligjin t'i bëjnë të arritshme të gjitha informacionet me karakter publik; t'i publikojnë propozim-programet, nënprogramet, strategjitë, qëndrimet, mendimet, studimet dhe dokumentet tjera të ngjashme të cilat iu referohen kompetencave të poseduesit të informacioneve; t'i publikojnë të gjitha thirrjet në procedurën për furnizime publike dhe dokumentacionit të tenderit, të publikojnë edhe informacione tjera të cilat dalin nga kompetenca dhe puna e tyre. Duke pasur parasysh dispozitën ligjore "poseduesit e informacioneve duhet t'i publikojnë" nuk është deri në fund e detyrueshme, kurse edhe informacionet janë të përgjithshme dhe gjenerale, transparenca në nivel lokal dukshëm do të përmirësohej me akt konkret, më të hollësishëm, me të cilin komunat do të obligohen në qasje të unifikuar në publikimin e informacioneve konkrete nga fushëveprimi i punës së tyre dhe me interes për qytetarët.

Në këtë kontekst është i rëndësishëm edhe aplikimi i Ligjit për shfrytëzimin e të dhënave me karakter publik, me të cilin përcaktohet obligimi i organeve dhe institucioneve nga sektori publik për publikim të të dhënave në "format të hapur" të cilat i krijojnë në realizimin e kompetencave të tyre në pajtim me ligjin. Metjithatë, zbatimi i këtij Ligji kërkon përgatitje më të mëdha dhe krijim të parakushteve teknike.

Ligji për vetëqeverisje lokale saktësisht e ka përkufizuar detyrën e komunës t'u mundësojë qytetarëve qasje në informacionet themelore për shërbimet të cilat ua siguron, në mënyrë dhe nën kushte të rregulluara me statut. Gjithashtu këmbëngul mbi informimin e publikut për punën e organeve të komunës (kryetari i komunës dhe këshilli i komunës), komisioneve të këshillit, si edhe të shërbimeve publike.

Ajo që mungon janë drejtime më të sakta të cilat do të jenë obligim për të gjitha komunat, me zbatimin e të cilave do të sigurohet një farë balancimi në publikimin e të gjitha informacioneve të rëndësishme, të përcaktuara mbi bazën e detyrimeve ligjore, por edhe në konsultim më të gjerë me sektorin qytetar. Në këtë mënyrë do të lehtësohet qasja në informacione, por edhe do të krijohet mundësi për përpunimin dhe realizimin e tyre më të lehtë, që është me rëndësi të veçantë për qytetarët, por edhe për organizatat të cilat organizojnë hulumtime për punën e



komunave në fusha të ndryshme.

Lehtësimi i qasjes në informacione dhe rritja e llogaridhënies, e rrit besimin e qytetarëve të pushtetit lokal dhe e nxit interesin për pjesëmarrjen e tyre në krijimin e politikave dhe vendimeve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi jetën në bashkësinë lokale.

Sa i përket pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve dhe të realizimit të vendimeve të komunave, me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Ligjin për vetëqeverisje lokale, si edhe Ligjin për referendum dhe me forma të tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve, është krijuar korniza juridike e cila siguron kushte normative për pjesëmarrje qytetare në nivel lokal.

Kodi etik i zyrtarëve lokalë<sup>3</sup> (kryetari i komunës dhe anëtarët e këshillit) në Republikën e Maqedonisë udhëzon që komunikimi është obligim i pushtetit lokal dhe paraqet pjesë e rregullt dhe e obligueshëm e punës së tij. Në Nenin 24 – “Publiku në marrjen e vendimeve”, zyrtari është i obliguar të japë shkaqe të hollësishme për vendimet dhe procedurat e marra, përveç për ato të cilat me dispozitë janë shpallur si të besueshme, në ç’rast vëmendje të veçantë u kushton fakteve të cilat konfirmojnë që procedurat e tilla janë në pajtim me dispozitat dhe janë me interes publik.

### 3.2. Analiza e gjendjes rrjedhëse në Republikën e Maqedonisë

Saktësia dhe qartësia e informacioneve, publiciteti i tyre dhe qasja e lehtë dhe përditësimi i vazhdueshëm i të dhënave, kontribuojnë në informimin më të mirë të qytetarëve. Pjesëmarrja aktive e qytetarisë në këto procese kërkon një komunikim në dy drejtime, i cili nuk do të bazohet vetëm mbi komunikimin rrjedhës dhe kohëpaskohshëm nga ana e komunës, por do të nënkuptojë edhe marrëdhënie proaktive me qytetarët dhe sektorin qytetar, konsultim me publikun dhe përfshirjen e tij të vazhdueshme në marrjen dhe implementimin e vendimeve.

Analiza e cila ishte realizuar në kuadër të këtij projekti mundësoi përpunim të të dhënave të cilat ishin marrë përmes pyetësorit anketues për komunat dhe organizatat qytetare, si edhe përmes analizës së UEB faqeve të komunave.

Për shkak të përceptimit të çështjes e cila ishte trajtuar në këtë hulumtim në mënyrë objektive, pyetjet të cilat u ishin parashtruar komunave, në shumicën e rasteve, u ishin parashtruar edhe të OQ-ve të përfshira në këtë hulumtim. Për shumicën e pyetjeve, ishte ofruar mundësi për më shumë nga një përgjigje.

Gjetjet të cilat ishin marrë si rezultat i analizës janë ndarë sipas tipit të pyetjeve të cilat janë përpunuar dhe sipas përshkrimit të gjendjeve në fushën e dhënë.

#### ❖ Komunikimi në kuadër të komunave

Komunikimi i vazhdueshëm, në kohë dhe i rregullt midis të punësuarve në komunë paraqet prioritet për çdo pushtet lokal. Puna efikase dhe funksionimi pa pengesa i pushtetit lokal kërkon këmbim të vazhdueshëm të informacioneve dhe bashkëpunim në të gjitha nivelet në komunë:

<sup>3</sup> [http://www.zels.org.mk/Upload/Content/Documents/Izdanija/Publikacii/MK/20Eticki\\_Code\\_MKD.pdf](http://www.zels.org.mk/Upload/Content/Documents/Izdanija/Publikacii/MK/20Eticki_Code_MKD.pdf)


kryetar komune, udhëheqës, zyrtarë dhe këshill (horizontal dhe vertikal). Pikërisht për këtë, është e nevojshme që çdo komunë t'i përkufizojë kanalet, format dhe veglat e komunikimit të brendshëm.

Sipas hulumtimit të realizuar të komunave në Republikën e Maqedonisë, komunikimi i brendshëm i komunave, në shumicën e rasteve, bazohet mbi komunikimin elektronik dhe mbajtjen e mbledhjeve javore të të punësuarve. Megjithatë, mbizotëron vlerësimi që e-korrespondenca e rregullt si praktikë e rregullt dhe/ose procedurë për ndarjen e informacioneve në kuadër të komunës mungon, që në mungesë të mekanizmave të tjerë të komunikimit, do të mund të pasqyrohej edhe mbi efikasitetin e punës të përfaqësuesve komunalë.

Përveç këtyre kanaleve të komunikimit, pjesa e të anketuarve i kanë vënë në dukje edhe mbledhjet mujore, platformat intranet, si edhe mbledhjet/kolegjiumet ditore, komunikimin e drejtpërdrejtë, Skajpin dhe forma të tjera të komunikimit në punën e përditshme me bashkëpunëtorët e tyre. Vetëm një komunë ka bërë vërejtje në mungesë të instrumenteve dhe procedurave të komunikimit.

Pyetjes së parashtruar për komunikimin e brendshëm në komuna, ishin dhënë më shumë nga një përgjigje. (Grafiku 1: Komunikimi i brendshëm në komuna)

**Grafiku 1: Komunikimi i brendshëm në komuna**




#### ❖ Transparenca e punës së këshillave komunalë

Seancat e këshillit të komunës, sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, janë publike dhe qytetarët kanë të drejtë të kërkojnë prani në seancat e këshillit. Vetëm në raste qartë të përcaktuara, prania e publikut mund të përjashtohet. Por, kur këshilli debaton për buxhetin e komunës, për llogarinë vjetore të buxhetit dhe për planet urbanistike, publiku në asnjë rast nuk mund të

përrjashtohet. Seancat e këshillit të komunës zakonisht paralajmërohen në UEB faqen e komunës ose në tabelat e shpalljes së komunës, 7 ditë para ditës së mbajtjes së tyre. Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale këshilli duhet të mbajë seancë së paku një herë në periudhë prej tre muajve.

Në hulumtimin e realizuar 40 komuna janë deklaruar që mbledhjet e këshillit komunal janë të hapura për publikun. Një komunë nuk i dha përgjigje kësaj pyetjeje, kurse asnjë komunë nuk është deklaruar që mbledhjet e këshillit nuk janë të hapura për publikun. (Grafiku 2: Publiku në mbledhjet e këshillit të komunës).

**Grafiku 2: A janë mbledhjet e këshillit të komunës të hapura për publikun?**



Njëkohësisht, analiza e UEB faqeve të komunave të cilat ishin përfshirë në këtë hulumtim tregoi që te pjesa e madhe e komunave mungon publikimi i informacioneve për seancat e caktuara të këshillit, rendin e ditës së seancave dhe për procesverbalet e seancave të mbajtura. Vetëm 29% të komunave të cilat ishin objekt i hulumtimit i publikojnë paraprakisht seancat e këshillit. Përveç kësaj, vendimet e këshillit publikohen në UEB faqen e komunës, por në kuadër të Buletinit zyrtar, që e vështirëson kërkimin dhe qasjen në informacionet e kërkuara.


Sa i përket publikimit të procesverbaleve nga seancat e mbajtura, vetëm 15% nga komunat e analizuar i publikojnë procesverbalet në UEB faqen komunale. Mënyra e publikimit të këtyre informacioneve është i ndryshme në varësi nga komuna dhe më shpesh informacionet e publikuara janë vështirë të arritshme.

#### ❖ Komunikimi i komunave me qytetarët

Me qëllim të identifikimit, instrumentet më të shpeshta të zbatuara për informim dhe komunikim midis komunës dhe qytetarëve, ishin parashtruar pyetje të cilat kishin për qëllim t'i pasqyrojnë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet pushteteve komunale dhe organizatave qytetare në raport të mekanizmave për komunikim dhe këmbim të informacioneve, të cilat do të ishin më efikase edhe për komunat edhe për qytetarët. Pyetjes së parashtruar: „Cila mënyrë e komunikimit të komunës Suaj me qytetarët më shpesh përdoret?“ numri më i madh i komunave janë deklaruar që mënyra më e shpeshtë e komunikimit me qytetarët janë ditët e pritjes për qytetarët në komunë, pastaj ueb faqet dhe takimet me qytetarët në bashkësitë vendore.


(Grafiku 3: Mekanizmat për komunikim të komunave me qytetarët). Edhe pse për këtë pyetje nuk ka pasur alternativë për më shumë përgjigje, shumica prej tyre kanë rrethuar më shumë se një përgjigje.

**Grafiku 3: Komunikimi i komunës me qytetarët**




Për dallim nga komnat, të cilat në shumicën e rasteve mendojnë që ditët e pritjes të komunës janë mënyra më e shpeshtë në të cilën qytetarët i marrin informacionet nga komuna, organizatat qytetare si burim më adekuat të informacioneve për punën e komunës e njohin UEB faqen e komunës. Në të vërtetë, për burim më të shpeshtë të shfrytëzuar të informacioneve është treguar UEB faqja e komunës, pastaj vijon buletini komunal, por ishin treguar edhe mënyra tjera të informimit: qasja e lirë në informacione me karakter publik, takimet e drejtpërdrejta me përfaqësuesit e komunës, trajnimet, mediumet elektronike, si edhe mediumet sociale. E dhënë interesante është që tabelat e shpalljeve, të cilat nga ana e komunave ishin vënë në dukje midis instrumenteve për informimin e qytetarëve, në përgjigjet e OQ-ve tërësisht mungojnë si mjet për informim. (Grafiku 3.1: Mënyrat për informimin e qytetarëve/OQ-ve për punën e komunave).

**Grafiku 3.1: Mënyrat për informimin e OQ-ve për punën e komunave**



Pyetjes së parashtruar: „Cila mënyrë e komunikimit mendoni se do të ishte më adekuate në komunën Tuaj në pajtim me madhësinë e komunës, mundësitë teknike të qytetarëve, strukturën e popullsisë? numri më i madh i komunave të përfshira në këtë hulumtim (31 komuna) si alternativë më adekuatë e kanë deklaruar UEB faqen e komunës. (Grafiku 4: Mënyra më adekuatë për komunikim me qytetarët, sipas komunave)


**Grafiku 4: Mënyra më adekuatë për komunikim me qytetarët, sipas komunave**



Midis propozimeve të cilat vetë komunat i dhanë si mënyra të mundshme për komunikim më të mirë me qytetarët janë edhe mediumet lokale, pyetësorët anketues me temë të caktuar, si edhe rrjetet sociale: Facebook, Twitter, Instagram, Youtube, Scribd, LinkedIn.

Është interesante të vërehet që edhe sipas organizatave qytetare, komunikimi elektronik (UEB faqet dhe e-korrespondenca) dhe takimet e drejtpërdrejta me përfaqësuesit komunalë, janë të identifikuara si mekanizma më adekuatë për komunikim me pushtetet lokale (Grafiku 4.1: Mënyra më adekuatë për komunikim me komunat, sipas OQ-ve).

**Grafiku 4.1: Mënyra më adekuatë për komunikim me komunat, sipas OQ-ve**



Një OQ është deklaruar që mënyrë e mundshme për komunikim efikas midis komunave dhe qytetarëve do të ishte edhe organizimi i forumeve tematike. Njëkohësisht, mund të vërehet se tabela e shpalljeve si mënyrë e komunikimit sa më pak shfrytëzohet nga ana e OQ-ve.

#### ❖ Transparenca dhe qasja në informacione për punën e komunave

Si edhe organizatat qytetare, ashtu edhe komunat mendojnë që UEB faqet janë midis veglave më adekuate për informimin në kohë të qytetarëve dhe për sigurimin e transparencës dhe qasjen në informacione.

Analiza e UEB faqeve të komunave, megjithatë, konstaton përditësim ende të pamjaftueshëm të informacioneve dhe të të dhënave. Vërehet edhe nevojë për qasje proaktive nga ana e poseduesve të informacioneve/komunave për publikimin e informacioneve me karakter publik me të cilat disponon komuna, dhe për të cilat ekziston interes nga ana e OQ-ve dhe qytetarëve.

Imazhi i përgjithshëm që është marrë gjatë analizës së ueb faqeve të komunave të cilat ishin përfshirë në këtë hulumtim treguan që UEB faqet e komunave janë të farfra në përmbajtje, kërkimi i informacioneve është i vështirë, faqet nuk ofrojnë vegla për konsultim, as shërbime elektronike. Në pjesën më të madhe të komunave të analizuara, UEB faqet kryesisht shërbejnë për qëllime promovuese, respektivisht publikimin e informacioneve për aktivitetet afirmative të realizuara në komunë. Gjithashtu, në një pjesë të komunave në të cilat përveç gjushës maqedonase në përdorim është edhe gjuha e bashkësisë e cila është e përfaqësuar me mbi 20%, shumë herë përmbajtjet e prezantuara në njërin nga gjuhët janë të varfra, kurse te disa prej tyre (5 komuna) fare ose vetëm një pjesë shumë e vogël e informacioneve janë të publikuara edhe në gjuhën maqedonase, edhe pse në vetë UEB faqet qëndron alternativë për zgjedhjen e gjuhës maqedonase.

Në këtë kontekst është interesant edhe krahasimi i përgjigjeve të dhëna të komunave dhe OQ-ve në raport të pyetjes *a janë informacionet që i publikon komuna rregullisht të përditësuara, të qarta dhe të kuptueshme për qytetarët*.

Derisa numri më i madh i komunave (83%) mendojnë që informacionet të cilat i publikojnë komunat janë të qarta dhe të kuptueshme për qytetarët, vetëm 6 OG, ose 20% prej organizatave qytetare kanë shprehur kënaqësi nga shkalla e qartësisë dhe kuptueshmërisë së informacioneve. 40% nga OQ-të mendojnë që informacionet të cilat i publikon komuna nuk janë rregullisht të përditësuara dhe të qarta për qytetarët, kurse numri i njëjtë i komunave (40%) janë përgjigjur me "nuk e di", që tregon se numër i madh i OQ-ve nuk e ndjekin ose nuk kanë informacione për punën e komunës.

Në raport të pyetjes për *publikimin e informacioneve për shërbimet komunale dhe kahjet për marrjen e tyre*, numri më i madh i komunave (32 komuna) janë deklaruar që publikojnë listën e shërbimeve, duke përfshirë edhe kahje të qarta për qytetarët. Më shpesh komunat i publikojnë këto informata në UEB faqet e komunave (40%), tabelat e shpalljeve (23%), si edhe përmes njoftimeve për publikun (22%). Në këtë pyetje komunat mund të jepnin më shumë se një përgjigje.

Duhet të vërehet që në raport të sigurimit të transparencës në punën e komunave, madje 70% nga komunat e anketuara janë deklaruar që nuk disponojnë me resurse të mjaftueshme njerëzore dhe teknike për sigurimin më të mirë të informacioneve në UEB faqen e komunës.

- Puna financiare e komunave

Për çdo banor të komunës është e rëndësishme e dhëna që taksat e ndryshme, siç për shembull tatimi mbi pronë, tatimi i trashëgimisë dhe dhuratës, tatimi i qarkullimit të pronës së patundshme, kompensimet për rregullimin e tokës ndërtimore, kompensimet nga veprimtaritë komunale, dhe tatimet e tjera, taksat dhe kompensimet, në fakt, janë pjesëmarrje e drejtpërdrejtë e qytetarëve/banorëve të komunës në buxhetin komunal.

Prej këtu, qytetarët kanë të drejtë të marrin pjesë drejtpërdrejt në procesin e krijimit të buxhetit, para se gjithash në procesin e përcaktimit të planeve vjetore dhe prioriteteve të komunës, si edhe në ndjekjen e realizimit të tij.

Me rëndësi të veçantë për këtë hulumtim ishte çështja e lidhur me *transparencën e buxhetit të komunës për vitin fiskal rrjedhës, por edhe informacionet të lidhura me shkallën dhe mënyrën e realizimit të tij.*

Nga të dhënat të marra nga hulumtimi doli që 76% të komunave të anketuara rregullisht e publikojnë propozim-buxhetin e komunës, kurse 92% të komunave rregullisht e publikojnë buxhetin e miratuar të komunës. Por, analiza e UEB faqeve tregoi që shpesh herë raportet nuk janë të qarta, janë vështirë të arritshme në ueb faqet dhe nuk ekziston vazhdimësi në publikimin e tyre.

Edhe pse numër i madh i komunave (76%) kanë deklaruar që e publikojnë propozim-buxhetin, asnjë nga komunat që janë objekt i hulumtimit nuk e ka publikuar propozim-buxhetin në UEB faqen e saj – mekanizëm i cili nga vetë komunat ishte theksuar si një nga më shpesh të zbatuarit për komunikim dhe informim të qytetarëve, dhe të cilin OQ-të më shpesh e shfrytëzojnë si burim i informimit për punën e komunave.

Analiza e UEB faqeve të komunave tregoi edhe mungesë të qasjes së unifikuar për publikimin e raporteve financiare të komunave, që mund të ndikojë mbi qasjen në informacione dhe qartësinë e të dhënave.

Në Tabelën 1 është dhënë shqyrtimi i përgjigjeve të komunave në raport të transparencës dhe publicitetit të buxhetimit dhe punës financiare të komunave, duke i përfshirë edhe furnizimet publike:

**Tabela 1: Shqyrtimi i dokumenteve dhe informacioneve të cilat komunat i publikojnë dhe përditësojnë:**

Dokumentet dhe informacionet	% e komunave
Propozim buxheti	76%
Buxheti i miratuar	93%
Buxheti qytetar	24%

Llogaria përfundimtare	85%
Raportet financiare kuartale dhe vjetore	93%
Raportet financiare programore	73%
Plani për furnizimet publike	54%
Raporti për realizimin e furnizimeve publike	51%
Raporti i Entit Shtetëror për Revizion	51%
Raportet financiare të ndërmarrjeve publike dhe të institucioneve	51%

- **Furnizimet publike të komunave**

Publikimi i furnizimeve publike është mënyrë për t'i minimizuar dyshimet dhe akuzat për shpenzimin pa destinim të parave të qytetarëve. Në këtë kontekst nuk mjafton që të respektohen vetëm obligimet ligjore për publikimin e furnizimeve, por është e nevojshme për t'u gjetur mënyrë përmes së cilës qytetarëve do t'u jenë të arritshme informacionet për furnizimet për të cilat ka nevojë të publikohen. Është e nevojshme të publikohen informacionet për ofertuesin më të suksesshëm dhe atë të zgjedhur, për shumën e kontratës, kornizën kohore për realizimin e obligimeve të parapara në kontratë si edhe pasojat nga kryerja joadekuate e obligimeve të parapara në kontratë.

Parandalimi i korrupsionit në furnizimet publike është një nga kushtet kyçe për përmirësimin e efikasitetit të politikave publike. Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës dhe llogaridhënies, Byroja e Prokurimit Publik dha rekomandim që të gjitha organet e kontraktuara, duke filluar më 01.01.2016. t'i publikojnë, respektivisht të mundësojnë qasje në UEB faqet e tyre deri te të dhënat vijuese nga realizimi i procedurave për dhënien e kontratave për furnizime publike:

- Plani për furnizime publike, si edhe ndryshimet dhe plotësimet e Planit gjatë vitit;
- Shpallja – vendosja e linkut pranë shpalljes e cila është shpallur në SEFP;
- Publikimi i njoftimit për kontratë të lidhur – vendosja e linkut pranë njoftimit në SEFP;
- Publikimi i njoftimit për kontratë të realizuar – plotësimi i njoftimit të këtillë në SEFP dhe vendosja e linkut për qasje në të njëjtin.

Shqyrtimi në Tabelën 1 tregon që pothuajse gjysma e komunave janë përgjigjur që nuk i publikojnë dokumentet dhe informacionet të lidhura me furnizimet publike në komunat e tyre. Analiza e UEB faqeve të komunave gjithashtu tregoi që në numrin më të madh të rasteve (83%) komunat nuk i publikojnë planet për furnizime publike në UEB faqet e tyre, por as njoftimet për furnizimet publike, dhe mungon edhe linku pranë njoftimit në Portalin unik elektronik për furnizime publike. Mungojnë edhe informacione për kontratat e lidhura për furnizime publike



dhe kushtet të cilat i përmbajnë ato, si edhe për vetë realizimin e kontratave.


Analiza tregoi që në zbatimin e transparencës së ashtuquajtur aktive i vogël është numri i komunave që mund të tregojnë shembull të mirë në publikimin e informacioneve të cilave u referohet Rekomandimi i Byros për Prokurime Publik. Ashtu, përdherisa 54% të komunave janë përgjigjur se e publikojnë dhe përditësojnë planin për furnizime publike, kurse 51% të komunave – se i publikojnë kontratat e lidhura (Tabela 1), UEB analiza e komunave dha imazh të ndryshëm. Sipas analizës së UEB faqeve të komunave vetëm 17% të komunave e publikojnë planin për furnizime në UEB faqen tyre, kurse asnjë nga komunat e analizuara nuk i publikon kontratat e lidhura. Sa i përket çështjes të lidhur me *qasjen e lirë në informacione*, të dhënat e hulumtimit tregojnë që nga organizatat qytetare të cilat kanë parashtruar kërkesë numri më i madh i OQ-ve janë deklaruar që kanë marrë përgjigje. 27% janë deklaruar që nuk kanë marrë përgjigje, kurse 23% nga organizatat janë deklaruar që deri tani nuk kanë parashtruar kërkesë deri te komuna.

Transparenca e ashtuquajtur aktive përveç që ka për qëllim të sigurojë numrin sa më të madh të informacioneve, të cilat do të jenë relevante dhe të kuptueshme për qytetarët, sipas natyrës së saj, ka edhe efekt shtesë mbi qytetarët dhe perceptimin e tyre për publicitetin e komunave. Transparenca aktive paraqet një nga mekanizmat për ndërtimin e besimit të qytetarët, me që nxitet interes më i madh dhe pjesëmarrje proaktive nga ana e qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve në nivel lokal dhe realizimit të tyre.

#### ❖ Pjesëmarrja qytetare dhe konsultimi

Në anketimin e realizuar, pyetjes së parashtruar *a organizon komuna konsultime me qytetarët dhe palët e tjera të interesuara kur diskutohen vendime të rëndësishme*, vetëm një komunë është deklaruar që nuk organizon konsultime me qytetarët. Të gjitha komunat e tjera janë deklaruar që realizojnë konsultime me qytetarët. Shumaca e komunave i janë përgjigjur kësaj pyetjeje me më shumë nga një përgjigje për çështjet të cilat kanë qenë objekt i konsultimeve me qytetarët (Grafiku 5: Konsultime të organizuara me qytetarët – sipas komunave)

**Grafiku 5: Konsultimet e komunave me qytetarët – sipas komunave**



Siç tregojnë rezultatet, në numrin më të madh të komunave të përfshira në këtë hulumtim, konsultimet më shpesh zhvillohen për çështjet të lidhura me planifikimin hapësinor dhe

buxhetin. Është e ulët përqindja e komunave të cilat kanë theksuar që i konsultojnë qytetarët në fazën e hartimit të planit për furnizime publike (9%), kurse 17% të komunave janë deklaruar që realizojnë konsultime edhe për çështjet tjera me interes për qytetarët: mjedisi jetësor, furnizimi me ujë, infrastruktura rrugore, rrjeti i kanalizimeve, zhvillimi ekonomik lokal, arsimit, kultura, sporti, si edhe konsultime për përcaktimin e projekteve me prioritet, gjatë hartimit të dokumenteve strategjike dhe programore.


Edhe sipas përgjigjeve të OQ-ve, konsultimet më të shpeshta me qytetarët komunat i organizojnë për çështje të lidhura me planifikimin hapësinor dhe buxhetin. OQ-të përmendën edhe çështje të tjera me interes të përgjithshëm, të cilat kanë qenë objekt i konsultimeve, siç për sheumbull zhvillimi ekonomik lokal dhe kultura, prëfshirja e grupeve të prekura dhe çështje të tjera që dalin nga kërkesat e qytetarëve.

Është interesante që ansjë OQ nuk e ka theksuar planin për furnizime publike si çështje për të cilën komunat organizojnë konsultime me qytetarët.

Po ashtu, vërehet që një pjesë e OQ-ve mendojnë se konsultimet me qytetarët fare nuk organizohen ose që nuk dinë a organizohen konsultime të tilla


Edhe kësaj pyetjeje OQ-të mund të përgjigjeshin në më shumë se një përgjigje (Grafiku 5.1 Konsultimet e organizuara me qytetarët – sipas OQ-ve).

**Grafiku 5.1. Konsultimet e komunës me qytetarët – sipas OQ-ve**



Në raport të pyetjes së parashtruar komunave sa konsultime me publikun janë të realizuara në vitin 2016, nga gjithsej 41 komuna të anketuara, 30 komuna kanë dhënë përgjigje. Numri më i madh i të anketuarve (40%) nuk dinin të jepnin përgjigje në këtë pyetje. Nga ato të cilat kanë dhënë përgjigje, numri më i madh i komunave (20%) kanë organizuar më pak nga 5 konsultime me qytetarët gjatë vitit 2016, kurse 17% kanë organizuar më shumë nga 20 konsultime. (Grafiku 6: Numri i konsultimeve me qytetarët në vitin 2016).


**Grafiku 6: Numri i konsultimeve të organizuara me qytetarët në vitin 2016\***



\*Përgjigjet e komunave

Në këtë kontekst OQ-ve u ishte parashtruar pyetja *a kanë marrë pjesë në ndonjë konsultim të organizuar nga ana e komunave në vitin 2016*. Përgjigjet e OQ-ve të prezantuara në Grafikon 6.1. tregojnë që më shumë se gjysma e OQ-ve (52%) e kanë shfrytëzuar mundësinë për pjesëmarrje në ndonjë nga konsultimet, por, njëkohësisht, është mjaft e lartë përqindja (48%) e atyre OQ-ve të cilat nuk e kanë shfrytëzuar këtë mundësi, d.m.th. nuk kanë marrë pjesë në asnjë konsultim, i realizuar në kuadër të komunës në vitin 2016.

**Grafiku 6.1: Pjesëmarrja e OQ-ve në konsultime në vitin 2016\***



\*Përgjigjet e OQ-ve

Të dhënat përmblledhëse nga komunat dhe nga OQ-të tregojnë që ende ekziston hapësirë për informim dhe përfshirje më të madhe të qytetarëve dhe të OQ-ve në proceset konsultative të pushteteve komunale. Siç ishte thënë më lartë, një nga mekanizmat më të suksesshëm është transparenca aktive e komunave, me të cilën mund të rritet interesi dhe pjesëmarrja e qytetarëve në proceset konsultative. Për shembull, pas analizës së realizuar të UEB faqeve të komunave, rekomandohet komunat t'i publikojnë raportet dhe rezultatet e konsultimeve të realizuara me qytetarët në UEB faqet e tyre, por edhe informacionet e publikuara, të lidhura me konsultimet t'i bëjnë më lehtë të arritshme.

#### ❖ Bashkëpunimi midis komunave dhe OQ-ve

Përveç informimit, me rëndësi të veçantë në sigurimin e transparencës dhe përgjegjësisë në punë është mundësia për komunikim të dyanshëm, që paraqet jo vetëm mundësi për komunikim dhe ndarje të informacioneve të komunës me qytetarët por edhe anasjelltas,

mundësi qytetarët të komunikojnë me komunën për shkak të sigurimit të shërbimeve, por edhe për shkak të realizimit të kontrollit të punës së komunës me shfrytëzimin e mekanizmave të dhëna ligjore.

Bashkëpunimi i vazhdueshëm midis pushtetit lokal dhe qytetarëve paraqet mekanizëm për nxitjen e pjesëmarrjes qytetare dhe marrjes së vendimeve në pajtim me nevojat dhe prioritetet e qytetarëve. Përfshirja qytetare efektive është thelbësore për qeverisjen e mirë. Vetëm kanal i dyanshëm i vazhdueshëm i komunikimit midis qytetarëve dhe komunës, mund të prodhojë vendime cilësore në nivel lokal dhe shkallë të lartë të bashkëpunimit dhe demokracisë, dhe me këtë përmirësim të cilësisë së jetës së përditshme të qytetarëve.

Duke iu ndalur *bashkëpunimit të deritanishëm të komunave me OQ-të*, përfaqësuesit komunalë kanë vënë në dukje që realizojnë shkallë të caktuar të bashkëpunimit me OQ-të, para se gjithash sa i përket çështjeve siç janë buxheti, planifikimi hapësinor, plani i furnizimeve publike dhe çështje të tjera me interes të përgjithshëm (në këtë kategori ishin të numëruara çështjet të lidhura me mjedisin jetësor, bujqësinë, kulturën, sportin, arsimin). 3% nga komunat nuk realizojnë bashkëpunim me OQ-të, kurse 6% nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje. (Grafiku 7: Bashkëpunimi i komunave me OQ-të).

**Grafiku 7: Bashkëpunimi i komunave me OQ**




Edhe pse pjesa e madhe e komunave kanë vënë në dukje që realizojnë konsultim me qytetarët për çështje të ndryshme (Grafiku 6) dhe bashkëpunim me OQ-të (Grafiku 7), pyetjes së parashtruar nëse megjithatë *ekziston hapësirë/nevojë për përfshirjen e OQ-ve në sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies më të madhe të komunës*, 66% nga komunat kanë dhënë përgjigje pozitive.

Pyetjes së njëjtë, të gjitha 33 OQ-të (100%) janë përgjigjur që ekziston nevojë për pjesëmarrjen e tyre më të madhe, me që do të sigurohet edhe transparenca dhe llogaridhënia më e madhe e komunave.

Pjesa më e madhe e OQ-ve (94%), gjithashtu, mendojnë që ekzistojnë informacione të cilat janë me interes për qytetarët dhe të cilat duhet të ndahen, por të cilat nuk ndahen nga ana e

pushteteve lokale (Grafiku 8: A ekzistojnë informacione të cilat janë me interes për qytetarët dhe të cilat duhet të ndahen, por nuk publikohen nga pushtetet lokale?)

**Grafiku 8: A ekzistojnë edhe të dhëna tjera të cilat komunat duhet t'i publikojnë?**




Duke e pasur këtë parasysh, është e rekomandueshme që komuna t'i konsultojë qytetarët edhe për atë se cilat informacione janë të dobishme dhe duhet të publikohen. Ajo gjithsesi do të kontribuojë edhe për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vetë krijimin e politikave në nivel lokal.

Në këtë kontekst, është interesant edhe perceptimi për *përfshirjen e përgjithshme të OQ-ve dhe në përgjithësi të qytetarëve në krijimin e politikave në nivel lokal.*

Madje 73% nga komunat mendojnë që pjesëmarrja e deritanishme e qytetarëve në krijimin e politikave në nivel lokal është në nivel të kënaqshëm (Grafiku 9: A janë qytetarët dhe OQ-të në përgjithësi në mënyrë të mjaftueshme të përfshirë në krijimin e politikave të komunës – përgjigjet e komunave).

**Grafiku 9: A janë qytetarët mjaft të përfshirë në krijimin e politikave?\***




\*Përgjigjet e komunave

Për dallim nga komunat, OQ-të janë me qëndrim diametralisht të ndryshëm – 90% të OQ-ve mendojnë që ka nevojë për pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në krijimin e politikave

lokale. (Grafiku 9.1: A janë qytetarët dhe OQ-të në përgjithësi në mënyrë të mjaftueshme të përfshirë në krijimin e politikave të komunës – përgjigjet e OQ-ve)

**Grafiku 9.1: A janë qytetarët mjaft të përfshirë në krijimin e politikave?\***



\*Përgjigjet e OQ-ve

\*\*\*

*Vlerësimi i përgjithshëm është që në pjesën më të madhe të komunave, në pajtim me përgjigjet e marra, qytetarët ende nuk marrin pjesë në mënyrë të mjaftueshme në procesin e marrjes së vendimeve dhe në krijimin e politikave lokale, kurse në punën e pushteteve lokale ende ka hapësirë për përmirësimin e transparencës aktive dhe të llogaridhënies në punën e tyre. Gjithashtu ka nevojë për informim më të madh të qytetarëve për çështjet për të cilat janë kompetente komunat, si edhe për mënyrat e realizimit të të drejtave të tyre për sigurimin e shërbimeve nga ana e komunës.*

#### 4. REKOMANDIMET

1. Duke pasur parasysh që 70 % të komunave janë deklaruar që ekzistojnë resurse të pamjaftueshme njerëzore dhe mbështetje teknike për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies më të madhe, përmes publikimit dhe përditësimit në kohë dhe të rregullt të të dhënave, është e nevojshme të bëhet analiza funksionale e kapaciteteve të komunës, me qëllim që në aktet për sistematizim dhe organizim të përcaktohet njësi/person organizative përgjegjëse si edhe përkrahje teknike adekuate për publikim të informacioneve për punën e organeve të komunës dhe për shërbimet të cilat i siguron, në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale, Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik, si edhe në pajtim me nevojat e qytetarëve.
2. Për t'u siguruar qasje sistematike në informim dhe komunikim është e nevojshme që komuna të përgatitë dokument (strategji, program ose plan) për komunikim të komunës me të gjitha grupet e synuara, duke i përfshirë OQ-të, biznes sektorin dhe qytetarët si grup më i gjerë i synuar, me qëllim pushtetet lokale t'i identifikojnë të gjitha grupet e synuara dhe të gjitha kanalet adekuate për komunikim. Duke marrë parasysh që asnjë OQ nuk e njoh tabelën e shpalljeve të komunës si vegël për informim dhe komunikim, rekomandohet UEB faqja të instalohet në mënyrë më aktive midis mekanizmave për informim dhe komunikim në të cilën do të publikohen të gjitha informacionet, si edhe ekzistimi i kanaleve të tjera për qytetarët të cilët nuk kanë qasje (të rregullt) në internet.
3. Në drejtim të ndërtimit të kulturës së afatgjatë organizative të punës, është e nevojshme që në çdo komunë të përgatitet dokument/procedurë për komunikim të brendshëm, si mënyrë zyrtare e ndarjes së informacioneve në nivele të ndryshme dhe në mënyrë të përcaktuar në dokumentin/procedurën në fjalë. Ndryshe, të punësuarit janë grupi i parë i synuar, dhe jo i fundit në sigurimin e transparencës së komunës. Pa bashkëpunim të brendshëm të mirë, rrjedhë të vazhdueshme të papenguar të informacioneve, është e pamundshme komuna të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie para qytetarëve.
4. Duke pasur parasysh se është vështirë për t'u gjetur një informacion i njëjtë në dy ueb faqe të ndryshme nga dy komuna të ndryshme, është e dukshme nevoja nga instalimi i qasjes së balancuar të publikimit të informacioneve në ueb faqet, respektivisht nga struktura e unifikuar e ueb faqeve të të gjitha komunave dhe nga publikimi i të gjitha informacioneve në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në informacione.
5. Për shkak të sigurimit të konsultimit të rregullt të qytetarëve në krijimin e politikave lokale, si edhe për shërbimet të cilat i siguron komuna, përveç mekanizmave të përcaktuar ligjorë për pjesëmarrje të qytetarëve, është e nevojshme të zhvillohen edhe mënyra të reja për konsultim me qytetarët, të cilat do të parashohin qasje proaktive në informimin e publikut, proces konsultativ për çështjet me interes për qytetarët, si edhe strukturë dhe procedurë të qartë të raportit për konsultimin e realizuar, me kornizë kohore për të gjitha aktivitetet e parapara.
6. Mbi bazën e analizës së nevojave të komunës, në varësi nga kapacitetet dhe resurset e saj, në aktet për sistematizimin dhe organizimin e komunës është e nevojshme të përcaktohet strukturë/person organizative përgjegjëse të obliguar për realizimin e konsultimeve. Është e dëshirueshme pushtetet lokale t'i marrin parasysh praktikën e mira të cilat tanimë i

praktikojnë disa nga komunat, kurse në procesin e konsultimit ta marrin parasysh edhe potencialin e bashkësive vendore dhe urbane.

7. Për shkak të sigurimit të qasjes proaktive të komunave në sigurimin e informacioneve me karakter publik, është e domosdoshme, në konsultim të gjerë me sektorin qytetar, të përgatitet dhe të miratohet dokument, i cili do t'i obligojë komunat në qasje të balancuar në publikimin e informacioneve nga fushveprimi i punës së tyre dhe me interes për qytetarët. Në atë mënyrë komunat do t'u mundësojnë qytetarëve qasje të papenguar dhe në vazhdimësi në informacione me interes për publikun, me që komunat do të tregojnë vullnet dhe publicitet për konsultim të vazhdueshëm dhe bashkëpunim me sektorin qytetar në proceset e krijimit të politikave në nivel lokal. Në këtë mënyrë, do të mund të pritët edhe interes i rritur dhe pjesëmarrje proaktive në këto procese nga ana e qytetarëve, të cilat me qasje në informacione të qarta, të kuptueshme dhe të përditësuara do të mund të paraqiten me propozime konstruktive dhe zgjidhje të informuara për zhvillim të qëndrueshëm.



## BIBLIOGRAFIA

### LIGJET DHE AKTET TJERA

Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 13/2006, 86/2008, 6/2010, 42/2014 dhe 148/2015).

Ligji për vetëqeverisje lokale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 05/2002)

Ligji për mborjtjen e informatorëve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 196/2015)

Kodi etik i zyrtarëve lokalë  
[http://www.zels.org.mk/Upload/Content/Documents/Izdanija/Publikacii/MK/20Eticki\\_Code\\_MKD.pdf](http://www.zels.org.mk/Upload/Content/Documents/Izdanija/Publikacii/MK/20Eticki_Code_MKD.pdf)

Ligji për ratifikimin e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale  
<http://mls.gov.mk/images/laws/Evropska%20povelba%20za%20lokalnata%20samouprava.pdf>

Ligji për ratifikimin e Protokollit shtesë të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale  
[http://mls.gov.mk/images/laws/zakoni/Zakon\\_130.2015.pdf](http://mls.gov.mk/images/laws/zakoni/Zakon_130.2015.pdf)

### DOKUMENTET STRATEGJIKE

Programi shtetëror për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe konflikti i interesave me Planin e veprimit 2016-2019

Strategjia për reformat e administratës publike 2010-2015

Draft-strategjia për reformat e administratës publike me Planin e veprimit 2018-2022

### PUBLIKIMET

Qytetari në vend të parë “Qendra për qeverisje me ndryshimet”  
<http://www.cup.org.mk/publications.php>

Indeksi i transparencës aktive “Qendra për komunikime qytetare”  
[http://www.ccc.org.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=308%3A-2017&catid=16%3A2012-02-23-22-01-53&Itemid=92&lang=mk](http://www.ccc.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=308%3A-2017&catid=16%3A2012-02-23-22-01-53&Itemid=92&lang=mk)

### ANALIZAT

Plani gjithëpërfshirës për qeverisje të mirë – Analiza e transparencës së vetëqeverisjes lokale në Maqedoni  
[http://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2017/08/Action\\_SEE\\_MK\\_08-08-2017.pdf](http://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2017/08/Action_SEE_MK_08-08-2017.pdf)

Pjesëmarrja qytetare në proceset e krijimit të politikave dhe marrjes së vendimeve në vetëqeverisjen lokale – Udhëzues për administratën komunale  
[http://www.most.org.mk/images/transparency/art/Vodic\\_za\\_opstinska\\_administracija\\_MKD.pdf](http://www.most.org.mk/images/transparency/art/Vodic_za_opstinska_administracija_MKD.pdf)

Raporti – Shqyrtimi i sistemit për furnizime publike  
[http://bjn.gov.mk/content/Analizi%20os%20stranstvo/SIGMA%20review%20of%20the%20Public%20procurement%20system%20May%202016\\_en-mk-t%20updated\\_clean.pdf](http://bjn.gov.mk/content/Analizi%20os%20stranstvo/SIGMA%20review%20of%20the%20Public%20procurement%20system%20May%202016_en-mk-t%20updated_clean.pdf)